




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 400/ 19
419/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina -Kryetar, z.Nuhi Paçarizi - Referues, z.Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesave të parashtruara nga operatorët ekonomik:“Pe-Vla-Ku”shpk-Prishtinë, me nr.400/19,dhe OE “JV RSM Company&Riviera shpk”-Prishtinë, me nr.419/19,kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për dhënie të kontratës: OE “Drini Company”shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ri-shpallje “Ndërtimi i Qarkores – Transiti i ri”, me nr. të prokurimit: 19-2998-5-1-1të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Komuna e Gjakovës,më datën:05.09.2019 mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHEN, si pjesërisht të bazuara ankesat e operatoreve ekonomik “Pe-Vla-Ku”shpk -Prishtinë, dhe OE “JV RSM Company & Riviera shpk”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ri-shpallje “Ndërtimi i Qarkores –Transiti i ri” , me nr. të prokurimit: 19-2998-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës.

II. ANULOHET,njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ri-shpallje “Ndërtimi i Qarkores –Transiti i ri” , me nr. të prokurimit: 19-2998-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV.Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues Pe-Vla-Ku”shpk -Prishtinë, dhe OE “JV RSM Company & Riviera shpk”-Prishtinë, aprovohen si pjesërisht të bazuara, ju bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e Njoftimit për Kontrate B05 është bërë me dt: 10.05.2019.

Sqarim i Dosjes se Tenderit është bërë me dt: 22.05.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 27.05.2019 .

Data e hapjes se ofertave është bërë me dt: 27.05.2019 .

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 24.06.2019.

Data e njoftimit mbi vendimin e AK është bërë me dt: 25.06.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim : “PE-VLA-KU” SH.P.K Dega në Kosovë-Prishtinë, është bërë me dt: 28.06.2019.

Data e vendimit të AK në Kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 08.07.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim “JV. RSM Company” SH.P.K. & “RIVIERA “ SH.P.K. 01.07.2019.

Data e vendimit të AK në Kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 08.07.2019.

Operatori ekonomik ankues: “Pe-Vla-Ku”shpk-Dega në Kosovë -Prishtinë, me nr.400/19 si palë e pa kënaqur kadeponuar ankesë në OSHP, me date: 11.07.2019, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ri-shpallje “Ndërtimi i Qarkores –Transiti i ri” , me nr. të prokurimit: 19-2998-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Komuna e Gjakovës, duke pretenduar se.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 27, 28, 51, 56, 57, 59, 68, 69, dhe nenin 71, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenet 2, 26, 27, dhe 41, të RRUOP –së.

Operatori ekonomik ankues: "JV RSM Company & Riviera shpk"-Prishtinë, me nr .419/19, si palë të pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me date 17.07.2019, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ri-shpallje "Ndërtimi i Qarkores –Transiti i ri", me nr. të prokurimit: 19-2998-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Komuna e Gjakovës, duke pretenduar se.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 27, 9.1 dhe 9.2, dhe 59, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 18.4 të RRUOP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 26.07.2019, ka autorizuar ekspertin e jashtëm teknik për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti i jashtëm teknik në raportin e datës: 09.08.2019, ka sqaruar pretendimet e OE ankues, Pe-Vla-Ku" shpk-Prishtinë dhe OE "JV RSM Company & Riviera shpk, -Prishtina.

Pretendimin ankimor të OE ankues: "PE-VLA-KU" SH.P.K ,Dega ne Kosovë-Prishtinë

Pretendimin:

Operatori ekonomik : SH." Drini Company" i cili është shpallur fitues me çmimin 2,999,470.37€ si çmimi me i ulëte , megjithëse është shpallur si tenderues i përgjegjshëm nga AK, ne kemi vërejtur se ai nuk është i përgjegjshëm për këto arsye:

Pretendimi i parë

OE në mbështetjen e tij bankare siç është kërkuar në dosjen e tenderit nuk e ka të saktë emërtimin e projektit si në dosjen " Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores- Tranziti i ri (ne gjuhen angleze: Re Tender Construction of Circular - New tranzit) por e ka me titull të projektit të mëhershëm Ndërtimi i Qarkores - Tranziti i Ri (ne gjuhen angleze si e ka ne Mbështetje Bankare : Construction of Qarkores – Tranziti i ri) gjë e cila po bije në kundërshtim me dosjen e tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktues .

Përgjigjeje në pretendimin e parë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar sepse Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të drejtë sepse Operatori ekonomik ne mbështetjen bankare të dorëzua i ka

te shënuara të dy numrat atë të prokurimit dhe atë të numrit të brendshëm sipas Dosjes se shpallur kurse emri mendoj se është një shkelje e vogël e cila nuk duhej të merret si shkelje.

Pretendimi i dytë

Tek pjesa e kontratave për punë të ngjashme kemi vërejtur se kontrata e OE: Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2015-2016, kjo kontratë nuk figuron si kontrata të tjera por që vërejmë se Kontrata: Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2014/2015 është përsëritur dy herë në mënyrën e njëjtë kurse kontrata Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2015-2016 nuk figuron në dosjen e tijë për punë të ngjashme dhe as nuk është pranimi teknik, veçmas një referencë e lëshuar në 03.11.2017, por që kjo kontratë nuk duhet të pranohet si kontrata valide e si referencë pasi që është e vitit 2014/2015 dhe që në dosje të tenderit kontratat për punë të ngjashme duhet me qenë të tri{3} viteve të fundit.

Përgjigjeje në pretendimin e dytë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar sepse operatori ekonomik të njëjtën kontratë (Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugës Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2015-2016) ne regjistrin e kontratave e ka përsëritur dy here kurse ne llogari është llogaritur vetëm një here.

Pretendimi i tretë

Tek kjo listë gjithashtu vërejmë se Operatori Ekonomik SH.Drini Company SH.P.K ka paraqitur kontratën Rikonstruktimi i Rrugës Kukës – Shishtavec, Lot 2 me vlerë 4,126,156.78€, në të cilin projekt Sh.Drini Company SH.P.K nuk është lideri por vetëm si partner i dytë me 40% i tij i cili i bije të ketë vlerën 1,600,000.00€. Nga kjo rezultojnë se Operatori Ekonomik nuk e përmbush kërkesën sipas dosjes së tenderit ku kërkohen që Operatorët Ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3{tri} vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratën. Në një vlerë se jo më pak se 5.000.000.00€ gjë që Operatori Ekonomik Sh.Drini Company nuk e përmbush këtë kriter dhe vlera e kontratave për punë të ngjashme mbërrin: 4,615,203.3€.

Përgjigjeje në pretendimin e tretë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik Pretendimi i OE Ankues te merret si i bazuar sepse ne baze te kontratës dhe formularit te vlerësimit Nga : Fondi Shqiptar i Zhvillimit tek % e bashkimit te OE. dhe përshkrimi i punimeve te kryera nga secili anëtar është se NNTTSH “DRINI COMPANY” SHPK -40% te punimeve i ka kryer dhe shuma e punimeve te kryera sipas kësaj kontrate është = $543,105,378.25 \text{ lek} \times 0.4 = 217,242,151.30 / 132.59 = 1,638,450.49 \text{ euro}$.

		Kontrata	Vlera e kontratës	Vlera e Kontratës kornizë	Kontrata nënshkrimi	Procesverbal/ pranimit teknik data	Vërejtje
1	623 -14 -018 - 521	Asfaltimi i rrugës Pastasel – Koznik KK Rahovec.	20,640.00	/	Aneks Po 04.07.2016	Po nr.8491 19.07.2016	E vlefshme
2	Mi/ 14/051 /211	Mirëmbajtja verore dhe dimërore 2014/2015 R. Prizreni 2	763,535.39	173.37	Po 14.11.2014	Po 07.11.2017	Është e dhënë ne dy kopje
3	/	Mirëmbajtja verore dhe dimërore 2015/2016 R. Prizreni 2	496,668.06	173.37	Jo	Po nr.8491 07.11.2017	Shënimet janë marr ne baze te referencës nr.8491 dt. 07.11.2017
4	Mi/205/17/ 5353/215	Mirëmbajtja verore dhe dimërore 2017/2018 R. Prizreni 2	260,040.22	/	Po 19.12.2017	Po 07.03.2019	E vlefshme
5	622-15- 316-521	Rehabilitimi dhe Asfalt i rrugëve ne Komuna e Prizrenit	319,364.84	19.87	Po 05.01.2016	Po 15.01.2018	E vlefshme
6	/	Mirëmbajtja verore dhe dimërore 2014/2015 R. Prizreni 2	/	173.37	Është e shënuar me larte me numrin rendor 2		E vlefshme
7	MI-14/051 /211	Mirëmbajtja verore dhe dimërore 2016/2017 R. Prizreni 2	705,199.57	173.37	Aneks kontrate Jo 25.08.2017	Po 07.03.2019	Nuk e ka prezantuar aneks kontratën 25.08.2018
8	0.34	Asfaltimi i rrugës ne fshatin Demjan	470,102.71	/	Po 29.08.2013 fillimi i Punimeve 02.08.2016	Po 12.09.2018	E vlefshme
9	410/04-19176	aneks Asfaltimi i rrugës ne fshatin Demjan	46,676.20	/	Po 03.07.2018	Po 12.09.2019	E vlefshme
10	632-16-081-511	Ndërtimi rrugës Bujar Roko – pjesa jugore e qytetit ne Gjakove	688,777.89	/	Po 02.06.2017	po	E vlefshme
11	632-16-081-511	Aneksi Ndërtimi rrugës Bujar Roko – pjesa jugore e qytetit ne Gjakove	64,917.87	/	Po 23.10.2017	Po 21.11.2017	E vlefshme
12	62500.18. 044.521	Asfaltimi i rrugëve neper fshatrat Komuna e Malishevës	96,969.00	/	Po 18.06.2018	Po 10.06.2018	E vlefshme

12	62500.18. 044.521/5	aneks Asfaltimi i rrugëve neper fshatrat Komuna e Malishevës	9,276.00	/	Po 17.08.2018	Po 01.10.2018	E vlefshme
14	CWC/ICB/2013/ WL-Rec54-1	Rikonstruimi i rrugës Kukës -Shishtavec lot 2 NNTSH DRINI COMPANY shpk -40%	1,638,450.49	/	Po 28.04.2014	Po 11.09.2017	E vlefshme
			4,378,750.61	Shuma e kontratave te vlefshme			

Pretendimi i katërt

Te Kapaciteti teknik dhe Profesional është kërkuar: Një Inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinieris mekanike – drejtimi komunikacion (transport) me minimumi pesë {5} vite përvojë pune pas diplomimit. Ndërsa është ofruar Bachelor i Komunikacionit rrugor dhe transportit.

Sqarim: duke u bazuar në neni 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale te Ligji i Prokurimit Publik të Republikës se Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/K-237, Ligjin 05/L-068, Ligjin 05/L-092, vërejmë se “inxhinieri” i prezantuar i komunikacionit nuk i përmbush kërkesat sipas dosjes së tenderit.

Përgjigjeje në pretendimin e katërt

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar pasi që anëtari i stafit profesional i propozuar nga OE. (Besar Jetish Krasniqi) me profesion Baçelor i Komunikacionit rrugor dhe transportit diplomuar me 24 shkurt 2010 nuk i plotëson kriterin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe Profesional e qe është kërkuar: Një Inxhinier i diplomuar i komunikacionit ose master i inxhinieris mekanike – drejtimi komunikacion (transport) me minimumi pesë {5} vite përvojë pune pas diplomimit te Njoftimit për Kontrate dhe Dosjen e tenderit.

Pretendimi i pestë

Operatori ekonomik ka paraqitur kontratat e punëtore, ku te gjitha kontratat janë me noterizim te njëjtë . klauzola e noterizimit është ne te gjitha e njëjtë si për nga forma ashtu për nga numër rendor i saj Nr. I LRP-se 3172/2019

Përgjigjeje në pretendimin e pestë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar sepse OE sepse me një numër (Nr. I LRP-se 3172/2019) i ka të vërtetuara të gjitha kontrata të punëtorëve, eksperti mendon se kjo është një shkelje dhe me këtë çështje mendoj se duhet të merren organet përgjegjëse sepse çdo kontratë është e veçantë dhe me numër identifikues të veçantë.

Pretendimi i gjashtë

Sipas nenit 28 i LPP-se Specifikimi teknik të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, OE i mungojnë deklaratat për specifikime teknike dhe specifikime teknike të detyrueshme, gjë e cila duhet të ishte në dosje

Përgjigjeje në pretendimin e gjashtë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar sepse në dosjen e dorëzuar të këtij grupi të operatorëve ekonomik ju mungon deklarata për specifikime teknike dhe specifikime teknike të detyrueshme.

Pretendimi i shtatë

Operatorit ekonomik i mungon dhe identifikimi financiar sipas dosjes së tenderit .

Përgjigjeje në pretendimin e shtatë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues sqaron se duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtime ky pretendim i operatorit ekonomik ankues të merret si e pa bazuar sepse dokumenti i identifikimi financiar nuk është e nevojshme të plotësohet në këtë fazë të tenderimit pra plotësohet vetëm nga operatori ekonomik fitues i kontratës.

Grupi i operatorëve ekonomik NNT “Burimi” & N.T.SH. “Bageri” & Sinani Ing Sh.P.K. megjithëse është shpallur i përgjegjshëm nga Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës, gjatë kontrollimit të dosjes së tij kemi vërejtur në shumë parregullsi si:

Pretendimi i parë

Mbështetja bankare e tyre nuk është si është kërkuar me dosjen e tenderit nuk e ka te sakte emërtimin e projektit si ne dosje “Ri- shpallje Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri (ne gjuhen angleze : Re tender Construction of Cirkular - New transit) por e ka me titull te projektit te mëhershëm Ndërtimi i Qarkores - Tranziti i Ri (Ne gjuhen angleze si e ka ne mbështetje Bankare : Construction of Qarkores – Tranziti i Ri) gjë e cila po bije ne kundërshtim me dosjen e tenderit te publikuar nga Autoriteti Kontraktues si dhe gjithashtu nuk e ka numrin e sakte te prokurimit te dosjes se tenderit, por e ka numrin e prokurimit te dosjes se vjetër : 632-19-663-5-1-1 te tenderit.

Përgjigjeje në pretendimin e parë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim mi OE ankues është i bazuar sepse Mbështetja bankare nuk është mbështetje për tenderin ne fjale sepse është mbështetje për tenderin e me hershem i cili është rishpalle dhe ka ndryshuar emrin dhe numrin e prokurimit dhe data e mbështetjes financiare është para datës se ri-shpallje se njoftimit për kontrate.

Pretendimi dytë

Sipas nenit 28 i LPP-se Specifikimi teknik te Ligjit OE i mungojnë deklarata për specifikime teknike dhe specifikacione teknike te detyrueshme , gjë e cila duhet te ishte ne dosje

Përgjigjeje në pretendimin e dytë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar sepse ne dosjen e dorëzuar te këtij grupi te operatorëve ekonomik ju mungon deklarata për specifikime teknike dhe specifikime teknike të detyrueshme.

Pretendimi i tretë

Operatorit ekonomik i mungon dhe identifikimi financiar sipas dosjes se tenderit .

Përgjigjeje në pretendimin e tretë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtime ky pretendim i operatorit ekonomik ankues të merret si e pa bazuar sepse dokumenti i identifikimi financiar nuk është e nevojshme te plotësohet ne këtë fazë te tenderimit pra plotësohet vetëm nga operatori ekonomik fitues i kontratës.

Pretendimi i katërt

Neni 68 i LPP-se - Gjendja Ekonomike dhe Financiare e Operatorit Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092

Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga Operatori ekonomik që të parashtrojë të dhëna për të treguar se ata a i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjë që operatori ekonomik Sinani Ing Shpk i mungon bilanci i auditimit për vitin 2018.

Përgjigjeje në pretendimin e katërt

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtime ky pretendim i operatorit ekonomik ankues të merret si i bazuar sepse gjatë shqyrtimit të dokumentacionit operatori ekonomik anëtar i konzorciumit nuk ka ofruar sipas Seksionit II FTD përkatësisht Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare pikat 8.1 & 8.2 Pasqyrat financiare të audituara 3 vitet e fundit respektivisht nuk ka dorëzuar Pasqyrat financiare të audituara për vitin 2018.

Pretendimi i pestë

Sipas dosjes së tenderit për kërkesat mbi mundësinë teknike dhe /ose profesionale pikat 9.1 & 9.2 O.E. duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 30 (tridhjetë) punëtorë në listën e stafit të paraqitur në ATK (minimumi për 2018) gjë e cila listë e punëtorëve O.E. NNT “Burimi” për vitin 2018 ka vetëm 21 punëtorë, ndërsa O.E. Sinani Ing Sh.P.K. për vitin 2018 ka 24 punëtorë, kurse O.E. NTSH “Bageri” Ka paraqitur listat për 3 vitet e fundit të cilave ju ka shtuar nga një faqe ku shihet qartë tek vula e protokollit ku tek secili vit shkruan që dokumenti përmban një faqe e jo 2 siç ka paraqitur operatori ekonomik në fjalë po ashtu faqet të cilat i ka shtuar janë të pa nënshkruara dhe vulosur nga ATK.

Përgjigjeje në pretendimin e pestë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtime ky pretendim i operatorit ekonomik ankues të merret si pjesërisht i bazuar sepse sipas FTD Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 30 (tridhjetë) punëtorë në listën e stafit të paraqitur në ATK (minimumi viti 2018) këtë kriter është i plotësuar nga anëtarët e grupit mirëpo pretendimi se operatori ekonomik O.E. NTSH “Bageri” Ka paraqitur listat për 3 vitet e fundit të cilave ju ka shtuar nga një faqe ku shihet qartë tek vula e protokollit ku tek secili vit shkruan që dokumenti përmban një faqe e jo 2 siç ka paraqitur operatori

ekonomik ne fjale është i bazuar sepse pas shqyrtimit të dokumentacionit konstatoj se dokumentacioni i lëshuar nga ATK përmban veten nga një flet fleta tjetër nuk i përket dokumentacionit të lëshuar nga ATK-ja.

Pretendimi i gjashtë

Duke u bazuar ne dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësin teknike dhe /ose profesionale pikat 9.1 & 9.2 si dhe duke u bazuar ne nenin 69 Aftësitë teknike dhe Profesionale të ligji i prokurimit Publik të Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me ligjin 04/L-137, Ligjin 05/L-068, Ligjin 05/092, konzorciumi nuk e ka të paraqitur listën e makinerive për këtë tender siç është kërkuar me dosjen e tenderit .Operatori ekonomik , NNT“ Burimi” ka paraqitur dy lista ku nuk shihen finisheret dhe as auto-mikserët.

Ndërsa tek marrëveshja me qira ka paraqitur makineri të cilat ju ka skaduar sigurimi siç janë këto makineri : targa 07-716- CTG, Targa 07-161-CT , targa 07-160 CT

Përgjigjeje në pretendimin e gjashtë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues të merret si e bazuar sepse sipas kërkesës me dosjen e tenderit Operatori ekonomik ka qen i obliguar të plotësoj listën e pajisjeve me llojin e mekanizmit, sasinë e kërkuar, sasinë që ofron ofertuesi si dhe të dhënat për pajisjen (viti I prodhimit ,gjendja e pajisjes , kamiona rexhistrimi i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj). Por Operatori ekonomik , NNT“ Burimi” ka paraqitur dy lista të cilat nuk janë të njëjta me formën e kërkuar. Dhe në këto lista mungojnë finisherat kurse ka ofruar DUD-in dhe kontratën e shitblerjes dhe Auto-mikseri për të cilin ka ofruar certifikatën e regjistrimit 05-724-DS, dhe të pretendimi se tek marrëveshja me qira ka paraqitur makineri të cilat ju ka skaduar sigurimi siç janë këto makineri : targa 07-716- CG, dt. rexh. Vlen deri:03-04.2019; Targa 07-161-CT dt. rexh. Vlen deri:19-04.2019, targa 07-160 CT dt. rexh. Vlen deri: 19.04.2019 siç duket nga dokumentacioni i dorëzuar regjistrimi këtyre makinerive ju ka kaluar me shume se një muaj nga data e dorëzimit të ofertave.

Pretendimi i shtatë

Konzorciumi ne fjale nuk i ka të paraqitur katalogët e detajuara për sinjalistikë vertikale dhe horizontale si dhe për elektrike dhe trupa ndriçues siç janë kërkuar ne dosjen e tenderit por vetëm autorizimin dhe licencat me standarde EN.

Përgjigjeje në pretendimin e shtatë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues te merret si e bazuar sepse sipas kërkesës me dosjen e tenderit grupi i operatorëve ekonomik nuk i ka dorëzuar katalogët e detajuar për sinjalistikë vertikale dhe horizontale si dhe për elektrike dhe trupa ndriçues si dhe autorizimet janë në emër të Titulli: Ndërtimi i Qarkores –Tranziti i ri, nr.i prokurimit : 632-19-633-5-1-1 ; nr. i brendshëm: 632-19-002-511pra është i ndryshëm nga ai i tenderit aktual me Titulli: Ri-Shpallje Ndërtimi i Qarkores-Tranziti i ri me nr. prokurimit 632-19-2998-5-1-1.

Pretendimi i tetë

Sipas Neni 27 i LPP-se - Dosja e tenderit të Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 , kërkesa mbi mundësin teknik /ose profesionale pika 9.1 & 9.2 Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë . Në një vlerë jo më pak se 5,000,000.00€ në rast të konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme

Në këtë rast OE. N.N.T. “ Burimi” lider i konsorciumit nuk e përmbushë këtë kriter, pasi që kontratat për punë të ngjashme të paraqitura nuk e kapin 60% të vlerës së kërkuar NNT “ Burimi” vlerën e kontratave e ka vetëm 2,378,640.07€ kurse N.T.SH “ Bageri” vlerën e kontratave e ka 2,844,523.45

Përgjigjeje në pretendimin e tetë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues te merret si e bazuar sepse kërkesa mbi mundësin teknik /ose profesionale pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 5.000.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme. Në bazë të regjistrit të ofruar si dhe kontratave dhe raporteve teknike apo procesverbaleve për punët e kryera eksperti konstaton se vlera e kontratave të natyrës së ngjashme të dorëzuara së bashku me kontrata certifikata ose referenca është 2.202.854,75 € pra lideri I grupit nuk e plotëson kriterin e kërkuar se duhet të ketë të paktën 60% kontrata të ngjashme.

Pretendimi i nëntë

Gjate kontrollimit te dosjes se tenderit te ketij konzorciumit ne kemi hasur ne disa kontratë qe ka paraqitur OE NNT " Burimi", te cilat nuk janë te rregullta , për të qenë pjesë e dosjes së tenderit . behet fjale për këto kontrata :

Asfaltimi i rrugëve urbane ne Shtime kontrate dhe ankesë kontratë vlerë 144,851.97 euro (kontrata dt. 02.06.2015, pranimi teknik dt. 08.12.2014).

Asfaltimi i rrugëve lokale neper fshatra Lot.2 Tupanave, Drenoc, Ngucat, Mirdite dhe Matosh Kontrate vlere 169,000.02 euro , Aneks vlere 19,500.00 euro (Kontrata është e vitit 2015 dhe nuk është e vulosur nga Autoriteti kontaktues , Aneksi nuk është i nënshkruar dhe vulosu fare , ka vetëm një reference por nuk tregon vitin kur janë përfunduar punimet).

Asfaltimi i rrugës ne fshatin Terdec vlere 45,89.00 euro (Kontrata e cila është e vitit 2015 i mungon Pranimi Teknik , ka vetëm një reference por nuk tregon vitin kur janë përfunduar punimet).

Punimi i kanalizimit ne fshatrat Senik, Gurishte, Drenoc , vlere 44,647.70 euro (kjo kontratë nuk mund te përdoret si pune e ngjashme ne rruge, por neujësjellës dhe kanalizim).

Ndërtimi i bazamentit te shtatores se ambasadorit Wiliam Woker dhe sanimi i dëmeve ne memorialin masakra e Reqakut , Kontrata vlerë 109,002.00euro aneks vlere 8,609.00euro (kjo kontratë nuk mund te përdoret si punë e ngjashme ne rruge).

Ndërtimi i shkollës fillore ne fshatin Bubavec , kontrata vlere 288,038.69 euro aneks vlere 27,852.13euro (kjo kontratë nuk munde te përdoret si pune e ngjashme ne rruge , por ne ndërtim) .

Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Dobraj e Madhe , vlere 78,128.63 euro (mungon Pranimi teknik apo Referenca) .

Rregullimi mi parterit te Universitetit te Gjakovës, vlere 165,002.00euro (kjo kontrate nuk mund te përdoret si kontrate e ngjashme për rruge por ne ndërtim).

Ekzekutimi i punimeve ne KM masakra e Reqakut , vlere 165,002.00euro (kjo kontrate nuk mund te përdoret si kontrate e ngjashme për rruge).

Ndërtimi dhe meremetimi i shtëpi vete familjare me gjendje te rende sociale , kontrata vlere 77,131.78 euro aneks vlere 7,704.34 euro kjo kontrate nuk mund te përdoret si kontrate e ngjashme për rruge por ne ndërtim).

Asfaltimi i rrugëve ne për fshatrat e komunës se Malishevës Senikngucat dhe Plloqice , kontrate vlere 116,168.00 euro , aneks vlere 11,250.00 euro (mungon Pranimi teknik dhe Referenca) .

Asfaltimi i rrugës Ujmir, Kontrata vlere 73,193.32 euro, aneks vlere 7,217.72 (mungon Pranimi teknik dhe Referenca)

Përgjigjeje në pretendimin e nëntë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues të merret si e bazuar sepse të gjitha këto kontrata të cekura më lart nga operatori ekonomik ankues nuk mund të merren si kontrata të natyrës së ngjashme të përfunduara me sukses sepse, ose janë kontrata të natyrës tjetër pra të cilat nuk kanë të bëjnë me rrugë, apo ju mungon pranimi teknik, referenca .

Te Operatori Ekonomik “Ledi Ing” SH.P.K. i cili operator ekonomik është shpallur i përgjegjshëm na Autoriteti Kontraktues : komuna e Gjakovës, gjatë kontrollimit të dosjes se ti kemi vërejtur shumë parregullsi .

Pretendimi i parë

Tek Aneksi 2 Deklaratën e Betimit nuk e ka të shkruar emrin e kompanisë tek pjesa ku duhet cekur emri Unë i poshtë nënshkruari duke përfaqësuar (Operatorin ekonomik që paraqitet) deklaroj në betim

Përgjigjeje në pretendimin e parë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues nuk është i bazuar sepse të Identifikimi i operatorit ekonomik i ka të shënuara emrin e kompanisë , Adresën , emrin e përfaqësuesit etj.

Pretendimi i dytë

Neni 68 i LPP-se – gjendja Ekonomike dhe Financiare e Operatorit Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092,

Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga Operatori ekonomik që të parashtrojë të dhënat për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

Operatori Ekonomik “Ledi Ing” SH.P.K. nuk e ka të bashkangjitur qarkullimin bankar për 3 vitet e fundit siç është kërkuar me dosjen e tenderit tek pjesa: Kërkesat mbi gjendjen Ekonomike dhe financiare 8.1& 8.2 Kapacitetet ekonomike dhe financiare : Operatori duhet të ketë një qarkullim financiar bankar me një vlerë të përgjithshme porë së paku 8,300,000.00 €, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë . ka të paraqitur vetëm gjendjen momentale për vitin 2018 edhe atë vetëm deri në muajin qershor.

Përgjigjeje në pretendimin e dytë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar sepse OE ne raportin mbi Llogarinë e Klientit ka paraqitur vetëm gjendjen momentale të subjektet me datën 11-06-2018 dhe është 7,112,853,07 .

Pretendimi i tretë

Edhe tek ky operator ekonomik vërejmë se nuk i ka kontratat për pune të ngjashme siç janë kërkuar në dosjen e tenderit. Kërkesat mbi mundësin teknike dhe /ose profesionale Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë . Në një vlerë jo më pak se 5,000,000.00€. Ky operator ekonomik ka të paraqitur në listën e tij kontrata nuk janë kontrata për pune të ngjashme si dhe ka kontrata të cilat nuk janë kontrata të tri (3)(viteve të fundit i ka vetëm tri kontrata valide po që këto kontrata nuk e mbërrijnë shumën prej 5,000,000.00€ vlera e kontratave të paraqitura nga “Ledi ing” Sh.P.K. është 3,060,832.20€.

Përgjigjeje në pretendimin e tretë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar sepse OE ne aneksin e regjistrimit të kontratave i cili është obligative, vlera e kontratave të realizuar për të cilat ka ofruar dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesës se këtij aneksi nuk i plotësojnë kriterin e kërkuar në baze të pikës III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 5.000.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Lista e kontratave të realizuara në 3 (tri) vitet e fundit, duke saktësuar titullin e kontratës, e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve

Në baze të listës së kontratave të realizuara për të cilat OE ka bashkëngjitur referencat apo certifikatat për kryerjen e punimeve, vlera e kontratave të paraqitura nga OE “Ledi ing” Sh.P.K. është = 3, 324,936.94 euro.

Pretendimi i katërt

Duke u bazuar ne Dosjen e tenderit tek kërkesa mbi mundësin teknik /ose profesionale pika 9.1 & 9.2 si dhe duke u bazuar ne nenin 69 Aftësia Teknike dhe profesionale te Ligji i Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, vërejmë se stafi i inxhinierëve ka kontrata te bazuara sipas rregullores se UNMIK-ut, si dhe dosjet e inxhinierëve nuk janë te noterizuara . Asnjëri nga inxhinieret e paraqitur nuk i kanë diplomat e noterizuara .

Përgjigjeje në pretendimin e katërt

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues nuk është i bazuar sepse ne baze te kriterit për vlerësim te Sqarimi shtese për OE kërkesa ne piken III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: te Dëshmia e kërkuar dokumentare: kërkohet: Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore, CV-a (original e nënshkruar nga inxhinieri), Diploma, Kontrata e punës me ofertuesin (origjinal, në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë); Kërkesa për sqarim (pyetja e parashtruar):..... Kontratat për stafin e rregullte a duhet te paraqiten patjetër origjinal apo mjafton kopje te noterizuar tek noteri ; Sqarim i informatave shtese nga AK: Për stafin e rregullt mjafton kopje e noterizuar nga noteri, pra nuk kërkohet noterizimi i diplomave te stafit profesional por vetëm i kontratave te punës.

Pretendimi i pestë

Operatori ekonomik si udhëheqës te punishtes ka paraqitur diplome Bachellor te ndërtimtarisë ndërsa është kërkuar një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë , drejtimi konstruktiv, infrastrukture rrugore -5 vite përvojë pune pas diplomimit , si udhëheqës i punishtes ne projektet ndërtimi, rehabilitimi te rrugëve , minimum 3 projekte te realizuara ne lëmin e kërkuar i cili inxhinier nuk i plotëson as kualifikimin universitar as përvojën e punës pese (5) vjeçare sipas kërkesës ne dosjen e tenderit.

Përgjigjeje në pretendimin e pestë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar sepse ne baze te kriterit për vlerësim te kërkesa ne piken III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional përkatësisht Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, infrastrukturë rrugore – 5 vite përvojë pune pas diplomimit , si udhëheqës I punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve. Minimum tri (3) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar , Operatori ekonomik për pozitën e Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, ka paraqitur

diplomën e Gafurr Rexha Bacholer i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv i diplomuar me datën 11 mars 2015 e cila nuk e plotëson kriterin e kërkuar.

Pretendimi i gjashtë

Ne dosjen e Operatorit ekonomik “Ledi ing” Sh.P.K. nuk kemi hasur te gjitha ISO standardet qe kerkohen me dosjen e tenderit , këtyre ju mungojnë:

- PASS 99 2012 – Sistemi i integruar i menaxhimit
- OHSAS 18001 2007 – Sistemi i Menaxhimit te Shëndetit dhe Sigurisë Profesionale
- ISO 28001 2007 – Sistemi i Menaxhimit te Sigurisë për zinxhirin furnizues .

Përgjigjeje në pretendimin e gjashtë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar sepse ne baze te kriterit për vlerësim te kërkesa ne piken III .2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional përkatësisht te pika ku kërkohet qe operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me licenca ISO nuk i ka te bashkangjitura këto Licenca ISO:

- PASS 99 2012- Sistemi I Integruar I Menaxhimit
- OHSAS 18001 2007- Sistemi I Menaxhimit të shëndetit dhe Sigurisë Profesionale
- ISO 28001 2007- Sistemi I Menaxhimit të Sigurisë për zinxhirin furnizues

Pretendimi i shtatë

Sipas Nenit 28 i LPP-se Specifikimet teknike te ligji i Prokurimit Publik te Republikës se Kosovës I plotësuar dhe i ndryshuar me ligjin Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 OE. i mungojnë deklaratat e për specifikimet teknike te detyrueshme gjë e cila duhet te ishin ne dosje.

Përgjigjeje në pretendimin e shtatë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues nuk është i bazuar sepse operatori ekonomik i ka te bashkangjitura ne dokumentacionin e dorëzuar me dosjen e tenderit dhe specifikimet teknike te detyrueshëm sipas kërkesë se dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate.

Konzorciumi: "LIRIGZONI SH.P.K. BENITA COMPANY SH.P.K. & ASFALT GROUP SH.P.K." nga Autoriteti Kontraktues : Komuna e Gjakovës është shpallur tenderues i përgjegjshëm por që gjatë kontrollimit të dosjes së tyre të tenderit kemi hasur në mungesë dhe parregullsi të dokumentacionit tenderues të tyre si më poshtë:

Pretendimi i parë

Neni 68 i LPP-se – gjendja Ekonomike dhe Financiare e Operatorit Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092,

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga Operatori ekonomik që të parashtrojë të dhënat për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës, si dhe sipas dosjes së tenderit

1.1 raportin ose raportet përkatëse nga një bankë ose me shumë banka

1.3 Kopjet e certifikatave të një apo me shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilanci i gjendjes, nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tilla të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të operatoreve ekonomik ose

1.4 Kopje të raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim.

Pastaj të dosja e tenderit thuhet tek: Operatori duhet të ketë një qarkullim financiar bankar me një vlerë të përgjithshme porë së paku 8,300,000.00 €, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, në rast të konzorciumit lideri duhet të ketë të paktën 60% të vlerës së qarkullimit. Ku në vërejmë se qarkullimi bankar të kërkuar sipas dosjes së tenderit asnjë anëtarë i konzorciumit nuk e ka në dosjen e tijë si dhe liderit të konzorciumit "LIRIGZONI SH.P.K" i mungon pasqyrat financiare të auditimit për 3 vitet e fundit.

Përgjigjeje në pretendimin e parë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar sepse asnjëri nga anëtarët e grupit nuk e kanë të dorëzuar me ofertën e tyre qarkullimin bankar për tri vitet e fundit po ashtu dhe anëtarit të grupit "LIRIGZONI SH.P.K" i mungon raporti i auditimit për tri vitet e fundit siç është kërkuar me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë në pikën III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Pasqyrat financiare të audituara për 3 vitet e fundit; Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kopja e pasqyrave financiare të audituara për 3 vitet e fundit dhe raporti i auditorit për pasqyrat përkatëse nga një Auditor i Licencuar ose ndonjë Kompani e Auditimit – (Të bashkëngjitet kopja e noterizuar e licencës së Auditimit).

Pretendimi i dytë

O.E. :”Asfalt Group” SH.P.K. i mungojnë deklaratat tatimore vjetore te tatimit ne te ardhura ose korporata si dhe i mungojnë pasqyrat financiare te auditimit për 3 vitet e fundit.

Përgjigjeje në pretendimin e dytë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar sepse O.E. :”Asfalt Group” SH.P.K i mungon i mungojnë deklaratat tatimore vjetore te tatimit ne te ardhura ose korporata si dhe raporti i auditimit për tri vitet e fundit siç është kërkuar me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrate ne piken III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Pasqyrat financiare të audituara për 3 vitet e fundit; Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kopja e pasqyrave financiare të audituara për 3 vitet e fundit dhe raporti i auditorit për pasqyrat përkatëse nga një Auditor i Licencuar ose ndonjë Kompani e Auditimit – (Të bashkangjitet kopja e noterizuar e licencës së Auditimit)

Pretendimi i tretë

Sipas dosjes se tenderit për kërkesat mbi teknike dhe /ose profesionale pikat 9.1 & 9.2 OE. duhet te ofroj dëshmi se ka se paku 30 (tridhjetë) punëtor ne listën e stafit te paraqitur ne ATK (minimum per 2018), ku vërejmë se grupi i operatoreve ekonomik: “LIRIGZONI SH.P.K. BENITA COMPANY SH.P.K. & ASFALT GROUP SH.P.K.” ka paraqitur një liste te ATK-se të datës 22.11.2018 të kompanisë partner në konzorcium “BENITA COMPANY SH.P.K” te cilës liste i mungojnë muaji nëntor dhe dhjetor i vitit 2018, ne te cilën liste nuk përfshihet stafi teknik dhe profesional qe kërkohet për kryerjen e punimeve .

Përgjigjeje në pretendimin e tretë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar sepse anëtarët e grupit te operatorëve ekonomik “LIRIGZONI SH.P.K & ASFALT GROUP SH.P.K.” nuk e kanë dorëzuar dëshminë se kanë së paku 30 (tridhjetë) punëtorë në listën e stafit të paraqitur në ATK (minimum viti 2018) kurse anëtari i grupit “BENITA COMPANY SH.P.K” ka paraqitur listën e stafit te paraqitur ne ATK per vitin 2018 vetëm për 10 muajt e pare (nga Janari deri tek tetori , kurse për muajin nëntor dhe dhjetor nuk i ka te paraqitur ne ATK).

Pretendimi i katërt

Sipas Nenit 28 i LPP-se Specifikimet teknike të ligji i Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës I plotësuar dhe i ndryshuar me ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 OE. i mungojnë deklaratat e për specifikimet teknike të detyrueshme gjë e cila duhet të ishin në dosje.

Përgjigjeje në pretendimin e katërt

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues nuk është i bazuar sepse operatori ekonomik i ka të bashkangjitura në dokumentacionin e dorëzuar me dosjen e tenderit dhe specifikimet teknike të detyrueshëm sipas kërkesë së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë

Pretendimi i pestë

Konzorciumit i mungon dhe identifikimi financiar sipas dosjes së tenderit

Përgjigjeje në pretendimin e pestë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim ky pretendim i operatorit ekonomik ankues të merret si e pa bazuar sepse dokumenti i identifikimi financiar nuk është e nevojshme të plotësohet në këtë fazë të tenderimit pra plotësohet vetëm nga operatori ekonomik fitues i kontratës.

Pretendimi gjashtë

Duke u bazuar në Dosjen e tenderit tek kërkesa mbi mundësin teknik /ose profesionale pika 9.1 & 9.2 si dhe duke u bazuar në nenin 69 Aftësia Teknike dhe profesionale të Ligji i Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 të grupit OE. "LIRIGZONI SHPK. BENITA COMPANY SHPK. & ASFALT GROUP SHPK." ju mungon Një inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me tri vite përvojë pune pas diplomimit si dhe lista e inxhinierëve .

Përgjigjeje në pretendimin e gjashtë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim ky pretendim i operatorit ekonomik ankues të merret si e bazuar sepse grupi i operatorëve ekonomik nuk e ka prezantuar stafin profesional në baze të pikës III .2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Një inxhinier i diplomuar i elektroteknikës me tri vite

përvojë pune pas diplomimit, Dëshmia e kërkuar dokumentare: CV-a (original e nënshkruar nga inxhinieri), Diploma, Kontrata e punës me ofertuesin (original, në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë).

Pretendimi i shtatë

Sipas Neni 27 i LPP-se - Dosja e tenderit të Ligji Nr. 04/L-042, i Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 , kërkesa mbi mundësin teknik /ose profesionale pika 9.1 & 9.2 Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë . Në një vlerë jo më pakë se 5,000,000.00€ në raste të konzorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme.

Në listën e projekteve për punë të ngjashme OE ka paraqitur edhe kontrata të punëve të tjera si ato të ndërtimit dhe ujësjellësve , ndërsa shuma e kontratave rrugë në bazë të dokumenteve të pranimit teknik dhe referencave është totali: 2,956,606.00 Euro që i bijnë të jete shumë më pakë se 5,000,000.00 euro e që lideri kryesor duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme

Sqarim:

Kontrata me titull: Ndërtimi , rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrugëve në Komunën e Leposaviqit me çmimi prej 7,042,798.23 euro nuk është e vëlturur nga AK: K. Leposaviqi, si dhe nuk e ka logon e komunës.

Kontrata me titull: mirëmbajtja e rrugëve në sezonin dimëror në Komunën e Skenderajt” me nr. Te prokurimit: 643174638221 e datës 31.01.2018, gjatë procedurave të kontrollimit të dhënave nuk e kemi gjete në platformën e E- prokurimit

Ndërsa kontratat tjera ashtu si shihet edhe në listën e LIRIGZONIT janë kontrata ta pa përfunduara dhe që nuk bëjnë pjese në këtë periudhë.

Përgjigjeje në pretendimin e shtatë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtime ky pretendim i operatorit ekonomik ankues të merret si pa bazuar sepse kontrata me titull: Ndërtimi , rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrugëve në Komunën e Leposaviqit me çmimi prej 7,042,798.23 euro duhet të merret si kontratë valide sepse kontrata është e nënshkruar nga Zyrtari i Prokurimit – Leposaviq dhe Kryetari i Komunës së Leposaviqit e cila kontratë i ka të bashkangjitur dhe Pranim dorëzimin e Punimeve të nënshkruar nga

komisioni prej tre anëtarëve si dhe Procesverbalin për pranim teknik të nënshkruar prej tre anëtarëve profesional sipas vendimit të Komunës së Leposaviqit si dhe menaxherit të projektit .

Pretendimi i tetë

Partneri i konzorciumit ‘ BENITA COMPANY’ SH.P.K. ka përshkruar punë të kryera në listën e kontratave, punë këto të ngjashme e jo të ngjashme por që, dokumentacioni bashkëlidhës mungonjë pothuajse për gjysmën e kontratave që i ka shkruar në liste , gjë e cila është kërkuar në dosjen e tenderit.

Kontrata me titull Saniimi i rrugëve me zhavorr AK: K.K. Gjakovë fillimi është në vitin 2013 dhe përfundon më 15.03.2015 e cila kontratë nuk bën pjesë në këtë periudhë që është kërkuar.

Përgjigjeje në pretendimin e tetë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtime ky pretendim i operatorit ekonomik ankues të merret si e bazuar sepse kjo kontratë është e përfunduar para shpalljes së njoftimit për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit .

Pretendimi i nëntë

Neni 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligji Nr. 04/L-042, i Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 , kërkesa mbi mundësinë pika 9.1 & 9.2 si dhe duke u bazuar dosja e tenderit kërkesa mbi mundësinë teknik /ose profesionale pika 9.1 & 9.2 , vërejmë se të konzorciumi mungon lista e plotësuar e pajisjeve të obligueshme nga dosja e tenderit.

Pajisja teknike makineri tre (3) kamionë nga makineritë që janë ofruar janë pa regjistrim para datës së tenderimit.

Përgjigjeje në pretendimin e nëntë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues të merret si e bazuar sepse anëtarët e grupit nuk e kanë plotësuar listën e pajisjeve e cila ka qenë e obligueshme me të dhënat e nevojshme si : Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve; Sasia e kërkuar

(cope); Sasia që ofron ofertuesi; dhe Të dhënat për pajisjet (viti I prodhimit ,gjendja e pajisjes , kamiona rexxh. i targave, mekanizimi ,dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim ,foto etj).

Pretendimi i nëntë

Konzorciumi ne fjale nuk i ka te paraqitur katalogët e detajuara për sinjalistikë vertikale dhe horizontale si dhe për elektrike dhe trupa ndriçues siç janë kërkuar ne dosjen e tenderit por vetëm autorizimin dhe licencat me standarde EN.

Përgjigjeje në pretendimin e nëntë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar sepse ne dosjen e dorëzuar te këtij grupi te operatorëve ekonomik ju mungojnë për sinjalistikë vertikale dhe horizontale si dhe per elektrike dhe trupa ndriçues siç janë kërkuar ne dosjen e tenderit përkatësisht seksioni II te FTD ; Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2 ; Kapaciteti teknik dhe profesional: Autorizimi e prodhuesit ose nga përfaqësuesi për sinjalizim horizontal dhe vertikal.; Dëshmia e kërkuar dokumentare : Autorizimin nga prodhuesit ose nga përfaqësuesi për sinjalizim horizontal dhe vertikal. (Me të cilën dëshmohet se prodhuesi- përfaqësuesi autorizon operatorin për furnizim me komponentët e sinjalizimit horizontal dhe vertikal si dhe katalogë të detajuar).

Pretendimi i dhjetë

Konzorciumit i mungon dhe identifikimi financiar sipas dosjes se tenderit

Përgjigjeje në pretendimin e dhjetë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues te merret si e pa bazuar sepse dokumenti i identifikimi financiar nuk është e nevojshme te plotësohet ne këtë fazë te tenderimit pra plotësohet vetëm nga operatori ekonomik fitues i kontratës

Dëmetmateriale

Përshkruajmënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne raste se përfshini pretendime për kompensim

Demet material te llogaritura janë rrethe 500€, për përgatitjen dosjes se tenderit.

Eksperti i jashtëm teknik në raportin e datës: 09.08.2019, ka sqaruar pretendimet e OE ankues, “JV RSM COMPANY” SH.P.K. & “RIVIERA” SH.P.K.

Neni 1- Qëllimi, thotë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Kurse AK-ja, me vendimin e saj bën shkelje të këtij neni, duke shpallur fitues një kompani që nuk ka ofruar tenderin epërgjegjshëm me çmimin më të ulët, dhe rrjedhimisht ka për qëllim dëmtimin e fondeve publike në vlerë prej 361,911.38 euro, që është një vlerë jashtëzakonisht e madhe, duke pasur parasysh buxhetin e vogël që posedon Komuna e Gjakovës në veçanti dhe Republika e Kosovës në përgjithësi.

Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

AK-ja bën shkelje të këtij neni, njëzetë siç ka vepruar tek neni 1, pasi që sipas këtij neni, autoritetet Kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit.

Dhe njëjtë AK-ja bën shkeljen e njëjtë me nenin 1, duke dëmtuar fondet publike në vlerë prej 361,911.38€

Neni 27- Dosja e Tenderit

AK-ja bën shkelje të vetë kritereve të vendosura në Dosjen e tenderit, pasi që neve si Grup të Operatoreve, na eliminon padrejtësisht, me kriteret që nuk kanë qenë të specifikuar detajisht në Dosjen e Tenderit, dhe siç dihet një tender përgatitet bazuar në kërkesat e vendosura në Dosje të tenderit dhe jo në dokumente tjera, në këtë rast Paramasa

Neni 27- Dosja e Tenderit

AK-ja bën shkelje të vetë kritereve të vendosura në Dosjen e tenderit, pasi që neve si Grup të Operatoreve, na eliminon padrejtësisht, me kriteret që nuk kanë qenë të specifikuar detajisht në Dosjen e Tenderit, dhe siç dihet një tender përgatitet bazuar në kërkesat e vendosura në Dosje të tenderit dhe jo në dokumente tjera, në këtë rast Paramasa

Neni 58 Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

AK-ja ka bere ekzaminimin dhe vlerësim te gabuar te tenderit tone, ne mospërputhje me nenin 59, duke na eliminuar padrejtësisht , me kriteret te pavendosura ne Dosjen te tenderit siç kërkohet sipas Ligjit për Prokurim Publik.

Pika 18.4 Rregullat dhe Udhëzuesi Operative për Prokurimin Publik

18.4 Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratës në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre.

Pra Autoriteti Kontraktues edhe njëherë bën shkelje esenciale të Ligjit të Prokurimit, me kriteret të papërcaktuara në FDT, pasi që kërkesat në FDT nuk korrespondojnë me arsyetimet e tyre për eliminim në vendimin e shpallur.

kërkojmë nga ana e OSHP-së të vërtetojë shkeljet e bëra nga komisioni i vlerësimit dhe lëndën ta kthejë në rivlerësim, sepse ne si grup i operatorëve ekonomik, kemi dorëzuar ofertën më të lirë dhe në përputhje me të gjitha kriteret e vendosura në dosje të tenderit.

Kurse neve si Grup i OE-ve jemi eliminuara për këto arsye:

Pretendimin i parë

Arsyeja e eliminimit nga AK-ja: Ju si Operator Ekonomik nuk keni prezantuar Certifikata për Standardet EN 12352:2006 (për ndriçimin publik siç është kërkuar në FDT).

Pretendimi OE ankues: Dosje të tenderit është kërkuar:“Autorizim origjinal i prodhuesit ose nga përfaqësuesi për pajisje elektrike dhe trupa ndriçues. Dhe si dëshmi të paraqitet Autorizimin nga prodhuesit ose nga përfaqësuesi për pajisjet elektrike dhe trupa ndriçues . (Me të cilën dëshmohet se prodhuesi-përfaqësuesi autorizon operatorin për furnizim me pajisje elektrike dhe trupa ndriçues, si dhe katalogë të detajuar)”.

Kurse ne si JV, kemi paraqitur Autorizimin origjinal të përfaqësuesit Multi Business Group, si dhe katalogët e të gjitha produkteve për pajisjet elektrike dhe trupa ndriçues.

Pra askund në dosje të tenderit nuk është e specifikuar se Certifikatat e cilave standarde duhet te paraqiten, ashtu siç pretendon AK-ja, por të njëjtat janë të vendosura në paramasë që nuk është vendi ku vendosen kriteret vlerësuese të tenderit.

Përgjigjeje në pretendimin e parë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim rekomandon se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues të merret si i pa bazuar sepse në dosjen e tenderit përkatësisht seksioni II të FTD ; Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2 ; Kapaciteti teknik dhe Professional: Të gjitha produktet që janë pjesë e projektit duhet të jenë me standarde EN - të ofrohen certifikata për standardet EN të produkteve të ofruara.; Dëshmia e kërkuar dokumentare Produktet që janë pjesë e projektit duhet të jenë me standarde EN (Produktet e ndriçimit publik dhe sinjalizimit janë të specifikuara në pozicionet e paramasës së projektit), - të ofrohen certifikata për standardet EN të produkteve të ofruara.

Pra gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar me rastin e dorëzimit të ofertës grupi i operatoreve ekonomik nuk ka prezantuar : Certifikatën për Standartin EN 12352:2006(për ndriçimin publik në ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME - Referohuni në specifikimin teknik paramasa).në piken 3 dhe 4 ku kërkohet që: Raportet e testimit për kompatibilitet me standardet EN (te dorëzohen me oferte) –

EN 60598-1 (2015), EN 12352:2006, EN 61000 – 3-2, EN 62031, EN 61347-1, EN 61347-2-13 EN 61547, EN 62031, EN 55015, EN 62471.

Pretendimin i dytë

Arsyeja e eliminimit nga AK-ja : Në paramasë tek ndriçimi publik pozicioni 3 dhe 4 janë kërkuar trupa ndriçues me karakteristika 80W dhe 150W, me katalogun e prezantuar nga ana juaj nuk ka trupa ndriçues 150W. Nuk e plotëson kërkesën e AK siç është kërkuar në FDT.

Pretendimi OE ankues: Po ashtu tek pozicioni 3 dhe 4 në paramasë, nuk është kërkuar Trupa ndriçues, por llamba për ndriçim LED, ashtu siç pretendon AK-ja, dhe ne kemi prezantuar katalogët sipas kërkesës së dosjes së tenderit, dhe jo siç pretendon AK-ja.

Përgjigjeje në pretendimin e dytë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim rekomandon se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues të merret si pjesërisht i bazuar sepse në dosjen e tenderit në ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME - Referohuni në specifikimin teknik paramasa). Te ndriçimi publik pozicioni 3: Furnizimi dhe instalimi i llambës -Karakteristikat teknike të ndriçimit ; - Kualitetit i LED - 6@0.7 A d.c -..... -është kërkuar që Shpenzimi i energjisë elektrike të jetë - 80 W

Operatori ekonomik ankues ne katalogun e prezantuar ka trupa ndriçues me karakteristika te shpenzimit te energjisë elektrike - 80 W

Kurse te Ndriçimi Publik ne pozicionin4: Furnizimi dhe instalimi i llambës, -Karakteristikat teknike te ndriçimit, -Kualitetit i LED - 6@0.7 A d.c, -Temperatura e drites - 4000 K, -....., -është kërkuar qe Shpenzimi i energjisë elektrike te jetë – 150 W, Operatori ekonomik ankues ne katalogun e prezantuar nuk ka trupa ndriçues me karakteristika te shpenzimit te energjisë elektrike prej -150 W.

Pretendimin i tretë

Arsyeja e eliminimit nga AK-ja : Ju keni prezantuar produkte dhe katalog të kompanisë NUOVA MARIC temperatura e procesimit të vijës ndarëse te shiritave të qarkullimit është 180-200C, përderisa është kërkuar që temperatura e procesimit të jetë 170-220C, e cila nuk përmbush kërkesat siç është kërkuar në FDT.

Pretendimi OE ankues: Ne kemi paraqitur autorizimet e kompanive prodhuese: Tamburini për tabela, Nuova Marie për sinjalizim horizontal-vija, dhe 3M për foljen e tabelave, dhe po ashtu kemi bashkangjitur Katalogët dhe Certifikatat EN, kurse AK-ja na ka eliminuara me arsyetimin që sipas paramasës (që nuk është dokumenti ku vendosen kriteret e vlerësimit) kemi paraqitur skedat teknike të ngjyrës termoplastike e cila është sipas kërkesës të FDT. Ky arsyetim nuk qëndron pasi që tek paramasa është kërkuar që temperatura e procesimit të ngjyrës të jetë minimum 170 dhe maksimum 220C. Kurse sipas skedave teknike te prodhuesit Nuova Maric, temperatura e procesimit është 180-200C që është brenda limiteve të caktuara tek paramasa.

Përgjigjeje në pretendimin e tretë

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin e pranuar në shqyrtim rekomandon se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues te merret si i bazuar sepse ne dosjen e tenderit ne ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME - Referohuni në specifikimin teknik paramasa). I. SINJALIZIMI HORIZONTAL , përkatësisht te poz. 1 ku kërkohet :Furnizimi dhe realizimi i vijës ndarëse të shiritave të qarkullimit (b=15 cm), me ngjyrë termoplastik - Trashësia e ngjyrës: > 2 mm, Pesha specifike: 1.95 – 2.05 kg/l, Temperatura e shkrirjes: > 90 °C, Temperatura e procesimit: 170 °C, max 220 °C, operatori ekonomik ankues ne skedat teknike te prodhuesit Nuova Maric, temperatura e procesimit është 180-200C që është brenda limiteve të caktuara tek pamasa.

Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezantuara në dosjen e tenderit në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit (në këtë aktivitet të prokurimit), sqaron se komisioni vlerësues nuk i ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar, ofertat e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, duke mos vepruar në pajtim, në tërësi me dispozitat ligjore të LPP-së dhe Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik. Prandaj, në bazë të analizës së mësipërme sqaroje se disa nga pretendimet e palëve në ankesë janë të qëndrueshme dhe të aprovohen si të bazuara, (për arsyet që u cekën tek përgjigja në pretendimet më lartë) dhe të njëjtin tender rekomandojmë, Autoritetin Kontraktues që ky aktivitet i prokurimit të RI- VLERËSOHET dhe të veprojë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të LPP-së Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092,

Autoriteti Kontraktues -Komuna e Gjakovës, me datë: 20.08.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "PE-VLA-KU" SH.P.K- Prishtinë, me datë: 14.08.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes parashtresës me shkrim të datës: 13.08.2019, ka njoftuar Operatorin ekonomik "JV RSM Company & Riviera shpk,- Prishtinë, lidhur me mendimin e ekspertit edhe pse shkresat i ka pranuar me kohë i njëjti nuk është përgjigjur.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 05.09.2019, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit të OSHP-së, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë, Paneli shqyrtues vendosi që ta kthejë në rivlerësim këtë aktivitet të prokurimit konform rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional të prokurimit, pa i shqyrtuar pretendimet ankimore të operatorëve ekonomik ankues për arsyet që do ti jep me poshtë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes parashtresës me shkrim të datës: 13.08.2019, ka njoftuar Autoritetin Kontraktues - Komuna e Gjakovës, me raportin e ekspertit shqyrtues profesional të prokurimit dhe Autoritetin Kontraktues - Komuna e Gjakovës, me datë: 20.08.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **pajtohet** me mendimin e ekspertit shqyrtues profesional të prokurimit.

Gjithashtu, Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes parashtresës me shkrim të datës: 13.08.2019, ka njoftuar edhe Operatori Ekonomik “PE-VLA-KU” SH.P.K – Prishtinë, me raportin e ekspertit shqyrtues profesional të prokurimit dhe Operatori Ekonomik “PE-VLA-KU” SH.P.K – Prishtinë me datë: 14.08.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **pajtohet** plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues profesional të prokurimit.

Ndërsa Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes parashtresës me shkrim të datës: 13.08.2019, ka njoftuar Operatorin ekonomik “JV RSM Company & Riviera shpk,- Prishtinë, lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues profesional të prokurimit edhe pse OSHP ka pritur një përgjigje, të njëjtit nuk janë përgjigjur, paneli shqyrtues konstaton se, pasi që OE “RSM Company”, është palë pa interes në aktivitetin e prokurimit në fjalë sepse i njëjti që nga data: 24. 07. 2019 deri më 24. 10. 2019, është në Listën e Zezë, andaj në pajtim me nenin 99 të LPP-së ky operator ekonomik nuk mund të merr pjesë në aktivitete të prokurimit dhe të shpërblehet me kontrata sipas vendimit të OSHP-së PSH. nr. 646/19 të dt. 23.07.2019.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 26 pika 1 të LPP- së në të cilin thuhet: Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar, konstaton se në rastin konkret operatori ekonomik “RSM Company”, është operator ekonomik i cili nuk mund të dëshmojë interes material për aktivitetin e prokurimit për faktin se ky operator ekonomik është konstatuar se ka paraqitur dokumente të rreme –falsifikuara në AK MI dhe për të njëjtin operator ekonomik OSHP-ja, ka marr vendim në pajtim me nenin 99.2 të LPP-së, duke e futur në listën e zeze të njëjtin OE për një periudhë prej tre muajve (3 muajve).

Paneli shqyrtues, sqaron se gjatë kësaj periudhe kohore derisa OE “RSM Company”, është në listën e zezë, duke u bazuar në nenin 99 të LPP-së të njëjtit operator ekonomik i ndalohet pjesëmarrja në aktivitete të prokurimit, sepse neni 99.2 i LPP-së specifikon: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje dhe ti respektoj ne përpikëri të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Komuna e Gjakovës.
- 1x1 OE“PE-VLA-KU” SH.P.K – Prishtinë,
- 1x1 OE“JV RSM Company & Riviera shpk -Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.